



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 987 Date 14.12.2007

PËR NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE ANONIME
“ UJESJELLES - KANALIZIME” PEQIN SH.A

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 “ Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare” ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1.Ndryshimin e statutit te shoqerise “Ujesjelles-Kanalizime” Peqin, sh.a si me poshte:

Neni 7, pika 3 ndryshon si me poshte:

Aksionet zotërohen ne masen 63.1 % nga Bashkia Peqin dhe 36.9 % nga Komuna Sheze, si perfaqesues te pronarit. Kjo e drejte ju kalohet me vendimin nr. 660 date 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve te shoqërive te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore”.

2.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit” Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



MINISTRI

GENCRULI



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UJËSJELLËSI SH.A. PEQIN
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

Nr. 1 .prot.

Peqin më 6/12/2015

V E N D I M

Nr. 1 Datë 6/12/2015

PËR DISA NDRYSHIME NË STATUTIN E SHOQËRISË UJËSJELLËSI SH.A.PEQIN

Mbështetur në Ligjin nr.8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, neni 8, pika I, shkronja ç) dhe pika II, shkronja a), neni 72, pika 5, shkronja a), Ligjin nr.9901, dt.14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 135, shkronja b) dhe g) dhe neni 213, Ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore", VKM nr.510, dt.10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njesitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", Kreu III, pika 1 dhe Kreu VI, pika 1, si dhe Statutit të shoqërisë, neni 9, pika 2, Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve në mbledhjen e datës 6/12/2015, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ujësjesit Peqin vendosi;

VENDOSI :

1. Në Statutin e shoqërisë Ujësjesit sh.a.Peqin bëhen këto ndryshime:
Pika 3, e nenit 7 "Aksionet" ndryshohet si më poshtë vijon;
"Aksionet zotërohen në masën 100% nga Bashkia Peqin".
2. Në zbatim të nenit 43 dhe 44 të Ligjit nr.9723 dt 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të depozitohet ky vendim brenda afateve ligjore pranë QKR.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Ujësjesit sh.a.Peqin
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

P/ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

KRYETARI

/ Saimir HASALLA /

